



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/1778 Data 09.09.2024
No. Date

PRISHTINË/A



U.D. Kryeshefi Ekzekutiv i NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë, në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, nenit 5 paragrafët 1 dhe 5 të Rregullores (QRK) nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, me qëllim të ndarjes së funksionit drejtues nga funksioni i pranimin dhe trajtimit të sinjalizimeve, ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë, si dhe shmangies së konfliktit potencial të interesit, nxjerr këtë:

VENDIM

(Për shfuqizimin e Vendimit nr. 02/1598, datë 03.09.2024 dhe caktimin e Zyrtarit Përgjegjës për Sinjalizim)

- I. **Shfuqizohet** Vendimi nr. 02/1598, datë 03.09.2024, me të cilin z. Mendim Mehmeti është caktuar Zyrtar Përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.
- II. Z. Habib Rama caktohet Zyrtar Përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë, për periudhë të pacaktuar.
- III. Zyrtari Përgjegjës nga pika II e këtij vendimi i ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me Ligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Rregulloren (QRK) nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Dokumentacioni, regjistri, evidencat, pajisjet dhe mjetet e qasjes që lidhen me sinjalizimet i dorëzohen Zyrtarit të ri Përgjegjës përmes procesverbalit të veçantë, duke garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me Vendimin nr. 02/1598, datë 03.09.2024, z. Mendim Mehmeti është caktuar Zyrtar Përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit në NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.

Pas caktimit të z. Mendim Mehmeti në pozitën e U.D. Kryeshefit Ekzekutiv, është vlerësuar e nevojshme që funksioni i Zyrtarit Përgjegjës për Sinjalizim të ushtrohet nga një punonjës tjetër. Ndarja e këtyre funksioneve synon ruajtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë në trajtimin e sinjalizimeve, shmangien e konflikteve potenciale të interesit dhe sigurimin e funksionimit të rregullt të mekanizmit të brendshëm të sinjalizimit.

Në përmbushje të obligimit të punëdhënësit për të pasur Zyrtar Përgjegjës për Sinjalizim dhe për të siguruar vazhdimësinë e këtij funksioni, është vlerësuar e arsyeshme që z. Habib Rama të caktohet në këtë detyrë për periudhë të pacaktuar, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2021. Për këto arsye, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1x1 z. Habib Rama;

1x1 z. Mendim Mehmeti;

1x1 Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;

1x1 Arkivit të ndërmarrjes.

UD Kryeshef Ekzekutiv

